

SPECIFIKIME TEKNIKE

“BLERJE E MJETEVE DIDAKTIKE PËR PAJISJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR / KOPSHTEVE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës”

SHËNIM PËR FOTOT/FIGURAT ORIENTUESE:

Fotot dhe figurat e paraqitura pas çdo specifikimi shërbejnë vetëm për orientim. Marka, modeli, ngjyrat apo elementet grafike të dukshme në to nuk përbëjnë kërkesa teknike të detyrueshme. Pranohen produkte ekuivalente, me kusht që të përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara. **Garancia** artikujve jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit të artikujve.

KËRKESA TË PËRBASHKËTA:

Të gjitha mjetet e destinuara për fëmijët e grupmoshës 3–6 vjeç duhet të jenë të reja, të sigurta, pa skaje të mprehta, të prodhuara me materiale jo toksike dhe lehtësisht të pastrueshme. Produktet duhet të jenë në përputhje me standartet. Për përmasat e përcaktuara lejohet një tolerancë prej $\pm 4\%$, përveç rasteve ku në specifikim është përcaktuar një interval i veçantë.

I. ZHVILLIMI I AFTËSIVE MANIPULUESE (KONSTRUKSIONE)

1. Konstruksion druri me kunjat e numra etj.

Materiali: Dru natyral cilësor, i lëmuar, me bojëra me bazë uji dhe jo toksike.

Përbërja/Kërkesat: Komplet i tërë me minimumi 88 elemente druri. Bazament me numrat 1–10, kunjat/boshtet, numrat, unazat me ngjyra dhe bashkësi përkatëse, elementet të jenë të lëvizshme dhe të paketohen në kuti.

Përmasat: Rreth $45 \times 15 \times 4$ cm.




Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

2. Tapet formues për dysHEME

Materiali: Shkumë EVA e presuar, jo toksike, e larshme, antirrëshqitëse dhe rezistente.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 6-8 pllaka që bashkohen me njëra-tjetrën, me shkronja dhe numra të lëvizshëm, me ngjyra të ndryshme.

Përmasat: Çdo pllakë rreth 30×30 cm; trashësia minimale 1 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

3. Konstruksion druri me forma gjeometrike.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me ngjyra jo toksike dhe skaje të rrumbullakosura.

Përbërja/Kërkesat: Komploti të ketë 60 elemente formë gjeometrike, si gjashtëkëndësh, trekëndësh, katror, drejtkëndësh... dhe forma të tjera gjeometrike.

Përmasat: Komploti $19 \times 11,5$ cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

4. Komplet me kafshë të buta shtëpiake dhe të fermës.

Materiali: Plastik i gomuar dhe cilësor

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 6 kafshë të ndryshme, p.sh. kalë, lopë, dele, dhe pula, etj. pa pjesë të vogla që shpëputen i ambalazhuar në qese plastike.

Përmasat: Komplet 22x15cm



Foto/figure orientue se modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

5. Komplet me kafshë të egra pylli.

Materiali: Plastik cilësor, i larmishëm.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 6 kafshë të egra të llojeve të ndryshme, luan, tigër, dre, elefant etj, pa pjesë të vogla që shpëputen i ambalazhuar në qese plastike.

Përmasat: Komplet 22x15cm



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

II. ZHVILLIMI I LEXIMIT DHE SHKRIMIT

1. Komplet druri me shkronja.

Materiali: Dru natyral, i lëmuar, rezistent dhe i lyer me bojëra jo toksike.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi në kuti të ndarë në kuadrate 56 elemente, ku të përfshihen shkronja të mëdha shtypi, shkronja shtesë dhe shenja pikësimi, paketim i ambalazhuar.

Përmasat: Kutia rreth 30×22 cm,



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

2. Tabela të ilustruara me mjetet e transportit.

Materiali: Karton i bardhë, minimumi 250 g/m^2 , me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Tabela të jetë në gjuhën shqipe e ilustruar, material karton i trashë, cilësi e pa re, ku të jenë vendosur llojet e mjeteve të transportit si: makinë, autobus, biçikletë, tank, vapor, tren, ambulance, eskavator, anije vaporësh, makinë betoniere, monopatinë, karrocë bebe, anije me vela, zjarrfikëse, aeroplan mbajtëse, traktor, motoçikletë, motoskafe, anije pasagjerësh, minimumi 18 mjete transporti. Në tabelë lart të shënohet emri që i përket mjetit.

Përmasat: Tabela 50×70 cm.




Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

3. Tabela të ilustruara të alfabetit (shkronja shtypi).

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe rezistent ndaj përdorimit.

Përbërja/Kërkesat: Të përmbajë të 36 shkronjat e alfabetit shqip, të shoqëruara me figura dhe emërtime në gjuhën shqipe.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

4. Komplet me shkronja lëvizore (36 elemente).

Materiali: Letër/karton i bardhë cilësor, i plastifikuar ose i laminuar, me ngjyra të qëndrueshme.

Përbërja/Kërkesat: Të përmbajë të 36 shkronjat e alfabetit shqip, të shtypit dhe të dorës, të shoqëruara me figura, me ngjyra të ndryshme, me xhep ose ndarje për ruajtje.

Përmasat: Komplet i jo më pak se 20 × 30 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

5. Tabela të ilustruara me stinët e vitit, muajt, javët.

Përbërja/Kërkesat: Tabelat të jenë dyfaqëshe, të paraqiten katër stinët të shoqëruara me figura me ngjyra e të shkruhet poshtë figurave si janë ditët dhe netët për çdo stinë. 12 muajt e vitit dhe kalendarin për çdo stinë që tregon ditët e javës e muajt e vitit dhe 7 ditët e javës, me ilustrim me figura me ngjyra dhe për çdo ditë të ilustruara me vargje edhe emërtimet e qarta në gjuhën shqipe. Në tabelë të shënohen objektivat që do të arrihen, terma kryesore dhe pyetje rreth përmbajtjes për secilën faqe.

Përmasat: 50 × 70 cm.


Përmasat: 50 × 70 cm.



6. Tabela të ilustruara: pjesët e trupit të fëmijës.

Përbërja/Kërkesat: Figura e plotë e fëmijës dhe emërtimet në gjuhën shqipe për pjesët kryesore të trupit, me vija treguese të qarta.

Përmasat: 50 × 70 cm.



7. Tabela dyfaqëshe me përralla të ilustruara.

Materiali: Karton i bardhë i trashë, minimumi 250 g/m², me printim me ngjyra në të dyja faqet dhe laminim.

Përbërja/Kërkesat: Komplet me 2 tabela dyfaqëshe dhe 4 përralla në gjuhën shqipe, “Borbardha dhe 7 xhuxhat”, “Zogu i vogël me pendë të hirta”, “Djali prej biskote” dhe “Pse hëna s’ka fustan”. Në tabelë të jenë shkruar teksti tek të katra përrallat e të ilustruara minimumi me 6 figura me ngjyra për çdo përrallë, që fëmijët të mësojnë kuptimin. Në tabelë të jenë shënuar objektivat që do të arrihen sipas programit mësimor, termat kryesore dhe çfarë duhet të jetë në vëmendje të mësueses, për të dyja faqet e tabelës.

Përmasat: Tabela 50 × 70 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

III. ZHVILLIMI I AFTËSIVE BASHKËPUNUESE DHE KRIJUESE

1. Komplet I veglave mjekësore.

Përmasat: Paketimi rreth 38×30 cm.



Përmasat: Paketimi rreth 38×43 cm.

4. Komplet me figura për të plotësuar.

Materiali: Libër me fletë të bardha cilësore, të përshtatshme për shkrim dhe ngjyrosje, me kapak kartoni, me figura të ndryshme me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Komplet me 2 libra me figura të ndryshme që plotësohen sipas modelit.

Përmasat: Secili libër rreth 20 × 30 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

5. Komplet penelash me bojëra uji (kolor).

Materiali: Bojëra uji të tretëshme, jo toksike, penela me fije të buta dhe doreza pa skaje të mprehta.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 12 ngjyra dhe 2-4 penela me madhësi të ndryshme, të vendosura në kuti të përshtatshme për ruajtje.

Përmasat: Paketimi rreth 22,5 × 8,5 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

6. Tabakë me ngjyra të ndryshme (kolor).

Materiali: Letër e njëtrajtshme, cilësore, 80–120 g/m², e përshtatshme për prerje, ngjitje dhe punime artistike.

Përbërja/Kërkesat: Komplet me minimumi 3 tabakë, secili me ngjyrë të ndryshme.

Përmasat: Secili tabak 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

7. Komplet lapustilësh.

Materiali: Trup plastik i qëndrueshëm, bojë me bazë uji, jo toksike dhe që lahet lehtësisht.

Përbërja/Kërkesat: 12 fibrakolorë me ngjyra të ndryshme, majë rezistente dhe kapak të ajrosur.

Përmasat: Paketimi rreth 17 × 10,5 cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

8. Komplet lapsash me ngjyra prej druri.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me majë të qëndrueshme ndaj thyerjes dhe pigmente jo toksike.

Përbërja/Kërkesat: 12 lapsa me ngjyra të ndryshme, të mprehshëm dhe të paketuar në kuti.

Përmasat: Paketimi rreth $7,5 \times 16,5$ cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

9. Tabela e të ushqyerit të shëndetshëm.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m^2 , i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Tabela të ketë të vendosur piramidën, jo më pak se 42 elemente fruta, perime, drithëra, bulmeti, etj., të ndara në tetë kolona dhe ushqime të shëndetshme, me emërtime në gjuhën shqipe dhe të ilustruara me figura ngjyra të ndryshme. Në tabelë të jenë vendosur objektivat që do të arrihen gjatë orës së mësimit, terma kryesorë, në vemendje të mësueses dhe pyetje rreth përmbajtjes, tabela të jetë me figura fëmijësh e ilustruar me shkrime mbi rëndësinë e llojeve të ndryshme të ushqimeve për jetën e njeriut etj.

Përmasat: Tabela 50x70cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

IV. MATEMATIKA

1. Tabela magnetike me numra për klasën.

Materiali: Tabela të jetë prej materiali pecikllazi me fushë manjetike, me ngjyrë të bardhë nga mbrapa dhe fshirëse dhe lapustil dhe përpara, numrat, shenjat e figurat janë material sintetik i presuar.

Përbërja/Kërkesat: Tabela përpara të ketë katër kolona horizontale ndarje. Në kolonën e parë e të dytë numrat nga 1-9, prapa çdo numri ka veprime matematikore dhe figura që tregojnë sasinë e vetë numrit në kolonën e dytë. Në kolonën e tretë dhe të katërt janë të vendosur shenja pikësimi dhe figura gjeometrike, mbrapa në rreshtin e tretë të jetë vendosur renditja e numrave. Tabela të ketë edhe varëse për tu varur në mur. Kjo foto është me pamje orientuese nga mbrapa.

Përmasat: Rreth $45 \times 32 \times 2,5$ cm.



Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.




1. Tabela të ilustruara me veprime zbritjeje e bashkësi.

Materiali: Plastik cilësore në bazo- reliev.

Përbërja/Kërkesat: Tabelat të jenë të plastifikuara në bazo-reliev. Minimumi 2 tabela me numra të ndryshëm për veprime matematikore të thjeshta zbritjeje, të shoqëruara me bashkësi figurash si fruta, kafshë ose sende.

Përmasat: Secila tabelë 40×60 cm.

Ushtrime me mbledhje
deri në 10

 $2 + 5 = \square$	 $4 + 4 = \square$
 $5 + 3 = \square$	 $1 + 8 = \square$
 $6 + 1 = \square$	 $10 + 0 = \square$

Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

2. Orë druri mësimore për klasën.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me bojëra jo toksike dhe skaje të rrumbullakosura.

Përbërja/Kërkesat: Ora të jetë material cilësor, të ketë formën e katrorit, me numrat 1–12, ndarje të qarta dhe dy akrepa të lëvizshëm, të fiksuar në mënyrë të sigurt. Ora të ketë bashkësi me figura të ndryshme që tregojnë sasinë për çdo numër nga 1-12 dhe me ngjyra të ndryshme. Bashkësitë të jenë me figura në formë puzzli me kunjë pa pjesë të vogla jo si në rastin e fotos orientuese.

Përmasat: Rreth $30 \times 30 \times 0,5$ cm.



Foto/figure ëorientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

3. Komplet druri me numra etj.

Materiali: Komplet prej druri cilësor, i lëmuar dhe i lyer me bojëra jo toksike, prej druri.

Përbërja/Kërkesat: Komplet i të ketë numrat 0–9, shenjat +, −, ×, ÷ dhe =, si dhe shkronja druri.

Brenda kutisë të ketë një tabelë të bardhë me fushë manjetike ku kryhen veprime matematikore ose shkrime me shkronjat nga fëmijët. Në kuti të ndodhen minimumi 100 elementë, ku nga këto 50 elementë të jenë me manjet. Komplet i të jetë i ambalazhuar në kuti kartoni cilësor.

Përmasat: Kutia rreth 31×22 cm




Foto/figure orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

4. Komplet numri shtatë dhe numri tetë.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m^2 , me printim dyfaqësh dhe laminim mbrojtës.

Përbërja/Kërkesat: Një tabelë dyfaqëshe: numri 7 në njërën faqe dhe numri 8 në faqen tjetër, me bashkësi, ilustrim edhe veprime të thjeshta. Tabela të jetë e ilustruar me figura të ndryshme ku të ketë pjesë tregimesh dhe pyetje të ndryshme që të jenë të ilustruara me veprime mbledhje e zbritje që tregojnë sasinë e numrit 7 e 8. Në tabelë të jenë shënuar objektivat që do të arrihen sipas programit mësimor, termat kryesore dhe në vëmendje të mësueses për situata të ndryshme.

Përmasat: 50×70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

5. Komplet loje druri me fruta.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me ngjyra jo toksike; kuti ruajtëse prej druri.

Përbërja/Kërkesat: Komplet i tërë 28 elemente druri me këto figura frutash, siç janë shalqi, rrush, ananas, banane, mollë, luleshtrydhe, portokall, të përshtatshme për lojë duke i nxjerrë nga kutia që është e mbyllur me kapak e duke i renditur sipas figurës që kanë të njëjlojtë njëra pas tjetrës.

Përmasat: Kutia rreth $16,7 \times 9,5 \times 4$ cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë

6. Komplet loje druri me kafshë.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me ngjyra jo toksike; kuti ruajtëse prej druri.

Përbërja/Kërkesat: Komplet i tërë 28 elemente druri me këto figura kafshësh siç janë, kali, dashi, lepuri, rosak, pule, lopë, derri, të përshtatshme për lojë duke i nxjerrë nga kutia që është e mbyllur me kapak e duke i renditur sipas figurës që kanë të njëjlojtë njëra pas tjetrës.

Përmasat: Kutia rreth $16,7 \times 9,5 \times 4$ cm.




Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

7. Komplet numri nëntë dhe numri dhjetë.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², me printim dyfaqësh dhe laminim mbrojtës.

Përbërja/Kërkesat: Një tabelë dyfaqëshe: numri 9 në njërën faqe dhe numri 10 në faqen tjetër, me bashkësi, ilustrim edhe veprime të thjeshta. Tabela të jetë e ilustruar me figura të ndryshme ku të ketë pjesë tregimesh dhe pyetje të ndryshme që të jenë të ilustruara me veprime mbledhje e zbritje që tregojnë sasinë e numrit 9 e 10. Në tabelë të jenë shënuar objektivat që do të arrihen sipas programit mësimor, termat kryesore dhe në vëmendje të mësueses për situata të ndryshme.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë

8. Tabela të ilustruara me bashkësi, me numrat 1–10.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Numrat 1–10, ku çdo numër të shoqërohet me bashkësinë me figurat që paraqesin sasinë përkatëse të numrit.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyra tmund të ndryshojnë.

9. Tabela të ilustruara me bashkësi, me numrat 1–20.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Numrat 1–20, ku çdo numër të shoqërohet me bashkësinë, me figurat që paraqesin sasinë përkatëse të numrit.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

10. Tabela të ilustruara me veprime me mbledhje.

Materiali: Plastik cilësore në bazo-reliev.

Përbërja/Kërkesat: Tabelat të jenë të plastifikuara në bazo-reliev. Minimumi 2 tabela me numra të ndryshme për veprime matematikore të thjeshta mbledhjeje, të shoqëruara me bashkësi figurash si fruta, kafshë ose sende.

Përmasat: Secila tabelë 40 × 60 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

11. Tabela të ilustruara me figura gjeometrike.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Të paraqiten rrethi, trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi, ovali dhe forma të tjera, me emërtimet përkatëse në gjuhën shqipe.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

12. Komplet tren druri me numra e bashkësi.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me bojëra jo toksike me elementë të lëvizshëm.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 12 elemente që formojnë trenin; numrat të shoqërohen me bashkësitë përkatëse, çdo numër shoqërohet me bashkësinë përkatëse të numrit nga 0-10. Fëmijët lëvizin elementët e drurit nga bazamenti e më pas i vensosin përsëri e më pas formojnë trenin.

Përmasat: Rreth 30 × 20 × 0,5 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

13. Komplet druri me numra 1–20 e bashkësi.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me bojëra jotoksike dhe kanale të sigurt për lëvizjen e elementeve.

Përbërja/Kërkesat: Tabelë labirinth me ngjyrë të verdhë, me 20 numra të lëvizshëm dhe 20 figura/bashkësi përkatëse. Nxënësit lëvizin numrat dhe i vendosin tek bashkësia përkatëse që i përket nga 1-20.

Përmasat: Rreth $40 \times 30 \times 1,5$ cm.




Foto/figurë orientues emodeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

14. Komplet numëratore druri me harqe.

Materiali: Bazament druri ose plastikë e qëndrueshme, harqe metalike të fiksuara dhe rruaza jo toksike.

Përbërja/Kërkesat: 10 harqe me rruaza me ngjyra të ndryshme, konstruksion i qëndrueshëm dhe paketim në kuti.

Përmasat: Rreth $13 \times 11,5 \times 4$ cm.




Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

15. Komplet druri me numra e shufra.

Materiali: Dru cilësor, i lëmuar, me bojëra jo toksike; kuti me ndarje për ruajtje.

Përbërja/Kërkesat: Komplet i të ketë një kuti ku të ketë numra, shenja, e shufra, të ketë ore, shkumës, një tabelë të vogël për veprime me numra, shenja matematike, figura dhe minimumi 104 shufra numërimi me ngjyra të ndryshme për të formuar bashkësitë me të cilat fëmijët bëjnë veprime.

Përmasat: Kutia rreth 24×17 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

V. NJOHJA E BOTËS

1. Komplet lupash me madhësi të ndryshme.

Materiali: Lente optike plastike/akrilik, kornizë dhe dorezë plastike rezistente, pa skaje të mprehta.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 2 lupa me madhësi të ndryshme dhe zmadhim të përshtatshëm për vëzhgime didaktike.

Përmasat: Diametri i lenteve rreth Ø40 mm dhe Ø60 mm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

2. Tabela të ilustruara: Bota ku jetojmë.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Tabelat të jenë të ilustruara me 7 kontinentet dhe 5 oqeanet dhe figura të njerëzve që të tregojnë si jetojnë njerëzit dhe elemente karakteristike të vendeve të ndryshme, emërtime në gjuhën shqipe. Në tabelë të ketë figura të ndryshme njerëzish dhe ndërtesash me ngjyra e pamje të ndryshme. Në tabelë të jenë shënuar objektivat që duhet të arrijë sipas programit mësimor, termat kryesore, çfarë duhet të ketë në vemëndje të mësues dhe pyetje rreth përmbajtjes.

Përmasat: 50 × 70 cm.




Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

3. Tabela të ilustruara: Sistemi ynë diellor.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Tabela të jetë e ilustruar me diellin dhe 9 planetet me ngjyra të ndryshme e madhësi të ndryshme dhe renditja e tyre sipas radhës, me emërtime dhe shpjegime në gjuhën shqipe. Tabela të jetë e ilustruar me figura të tjera si raketë, kometë, astronaut, teleskop, jashtëtokësor, sistemi diellor e planetet që rrotullohen rreth tij dhe një model eksperiment me 14 figura për ndërtimin e sistemit diellor. Në tabelë të jenë shënuar objektiva që do të arrihen sipas programit mësimor, terma kryesore dhe ndërtimi i sistemit diellor.

Përmasat: 50 × 70 cm.




Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

4. Tabela për qarkullimin e ujit në natyrë.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Në tabelë të paraqitet në mënyrë të qartë avullimi, kondensimi, precipitimi dhe grumbullimi i ujit. Këto të jenë të ilustruara me vargje ku të shpjegohet si ndodhin këto procese të mësipërme. Tabela të jetë e ilustruar me 6 figura me ngjyra të ndryshme dhe të ilustruara me shkrime dhe një poezi humoristike në lidhje me temën. Në tabelë të jenë shënuar objektivat që do të arrihen, termat kryesore dhe 3 eksperimente, eksperimenti 1, eksperimenti 2 dhe eksperimenti 3, të ilustruara me shkrim si veprohet në çdo eksperiment.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

5. Tabela të ilustruara për Himnin e Flamurit.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Tabela të jetë e ilustruar me pjesë nga teksti i Himnit të Flamurit Kombëtar, me patriotët e Kombit Shqiptar, si Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza, të shoqëruar me shpjegimet përkatëse për figurën e tyre, të jetë e ilustruar dhe vajza Marigo që qëndisi Flamurin Kombëtar. Në tabelë të jenë objektivat që do të arrihen në lidhje me temën sipas programit mësimor Sa të dua Shqipëri, termat kryesore dhe në vëmendje të mësueses.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

6. Pikatore.

Materiali: Plastikë e tejdukshme, fleksibël, jo toksike dhe e ripërdorshme.

Përbërja/Kërkesat: Me bulb të butë dhe shkallëzim të dukshëm, e përshtatshme për eksperimente didaktike nën mbikëqyrjen e edukatores.

Përmasat: Gjatësia rreth 7 cm; kapaciteti 1–3 ml.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

Termometra.

Materiali: Termometër pa zhivë, me lëng matës jo toksik ose tip digjital, me bazament plastik të qëndrueshëm.

Përbërja/Kërkesat: Për matjen e temperaturës së ambientit, me shkallë celsius të qartë dhe të lexueshme, jo termometër mjekësor prej qelqi.

Përmasat: Rreth 25×6 cm, intervali orientues -30°C deri $+50^{\circ}\text{C}$.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

7. Komplet magnetesh në formë patkoi.

Materiali: Magnete të veshura me plastikë/bojë mbrojtëse, me skaje të rrumbullakosura.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 2 magnete në formë patkoi, me pole të dallueshme me ngjyra, të përshtatshme për demonstrime didaktike.

Përmasat: Gjatësia e secilit magnet rreth 8–10 cm.




Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

8. Tabela: Të njohim frutat dhe perimet.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², i laminuar dhe me printim me ngjyra.

Përbërja/Kërkesat: Të përmbajë lloje të ndryshme frutash dhe perimesh, me ilustrime të qarta dhe emërtimet përkatëse në gjuhën shqipe.

Përmasat: 50 × 70 cm.




Foto/figurë orientuese modeli, marka dh engjyrat mund të ndryshojnë.

9. Tabela dyfaqëshe për njohjen e botës së kafshëve.

Materiali: Karton i trashë, minimumi 250 g/m², me printim dyfaqësh dhe laminim mbrojtës.

Përbërja/Kërkesat: Në njërën faqe kafshët e egra/tokësore dhe në faqen tjetër kafshë ujore, me ilustrime dhe emërtime në gjuhën shqipe.

Përmasat: 50 × 70 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

1. Komplet set sportiv tenisi.

Materiali: Raketa prej plastike rezistente ose materiali kompozit të lehtë; topa të butë dhe jo toksikë.

Përbërja/Kërkesat: Minimumi 6 elemente: 2 raketa, 1 top i lehtë dhe 3 elemente/aksesorë mbështetës për lojë ose vendosje.

Përmasat: Paketimi rreth 30×18 cm; raketat të përshtatshme për fëmijë 3–6 vjeç.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

2. Komplet druri pingpongu.

Materiali: Raketa prej druri të lëmuar, me doreza të sigurta; topa plastikë të lehtë.

Përbërja/Kërkesat: 2 raketa 2 topa pingpongu.

Përmasat: Paketimi rreth 20×30 cm; raketat me gjatësi rreth 20–25 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

3. Topa me ngjyra e madhësitëndryshme.

Materiali: Gomë/vinil i butë, elastik, jotoksik dhe i përshtatshëm për përdorim brenda dhe jashtë.
Përbërja/Kërkesat: Minimumi 6 topa, me ngjyra të ndryshme dhe në të paktën 2 madhësi; sipërfaqe që kapet lehtë nga fëmijët.
Përmasat: Perimetri rreth 32–46 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

4. Kompletlitarëshkërcimi.

Materiali: Litar fleksibël PVC/tekstili, jo toksik, me doreza plastike elektronike.
Përbërja/Kërkesat: Minimumi 4 litarë me ngjyra të ndryshme; gjatësi e rregullueshme dhe lidhje e sigurt me dorezat.
Përmasat: Gjatësia e secilit litar rreth 2–2,5 m.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

5. Komplet birilash plastike

Materiali: Plastikë e qëndrueshme, jo toksike, me skaje të rrumbullakosura dhe bazë të qëndrueshme.

Përbërja/Kërkesat: 10 birrila dhe 2 topa të lehtë, me ngjyra të ndryshme, të paketuara së bashku.

Përmasat: Paketimi rreth 35×24 cm; lartësia e birilave rreth 20–25 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.

6. Tabelë dhe kosh basketbolli për fëmijë.

Materiali: Plastikë/metal i qëndrueshëm, me bazë të stabilizuar, skaje të rrumbullakosura dhe rrjetë tekstili.

Përbërja/Kërkesat: Tabelë, unazë, rrjetë, top i lehtë dhe sistem montimi; lartësi e përshtatshme ose rregullueshme për fëmijë 3–6 vjeç.

Përmasat: Tabelë rreth 40×30 cm; diametri i unazës rreth 29,5 cm; lartësia 49.5–109 cm.



Foto/figurë orientuese modeli, marka dhe ngjyrat mund të ndryshojnë.